



# Ermira Hoxha

Drejtor Drejtorie

KONTROLLI I LARTË I SHETIT

Znj. Ermira Hoxha ka përfunduar studimet e larta në vitin 2004 në Universitetin Bujqësor të Tiranës, duke fituar titullin “Inxhinier Agrar”. Në vitin 2016 ka përfunduar studimet për “Financë-Kontabilitet” në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Ajo ka një eksperiencë prej rreth 6 vite në sektorin privat, ndërsa duke filluar që nga muaji shkurt i vitit 2012 punon pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit. Gjatë këtyre viteve znj. Hoxha ka ushtruar detyrën e Specialistes, Auditueses së Parë dhe Auditueses së Lartë në Departamentin e Auditimit të Performancës dhe në Departamentin e Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore.

Aktualisht Znj. Hoxha ushtron detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Kontrollin e Lartë të Shtetit. Gjatë karrierës së saj ka ndjekur disa trajnime të rëndësishme ndërkombëtare për rritjen e kapacitetit profesional si:

- Në vitin 2018, ka ndjekur programin 5 mujor të “Internship”-it në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), në Luksemburg, ku ka qenë pjesë e Departamentit “Përdorimi i Qëndrueshëm i Burimeve Natyrore”.
- Në vitin 2019, ka qenë pjesë e programit të trajnimit 4 mujor, “International Auditor Fellowship Program”, në GAO – “Zyra e Llogaridhënies së Qeverisë së SHBA-ve”, në Washington DC, ku ka ndjekur 640 orë trajnimi në fushën e auditimit, drejtimit dhe zhvillimit personal të përbërë nga kurse, seminare dhe e-learning, si dhe ka përgatitur punimin strategjik përkatës.


Përgjatë karrierës në KLSH ka shërbyer si trajnere në disa tema për Auditimin e Performancës, si dhe ka qenë drejtuese e disa auditimeve të përbashkëta të zhvilluara me SAI-t homologe.


Gjithashtu, në vijimësi ka marrë pjesë në trajnime, konferenca, seminare, të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në tema që lidhen me auditimin e jashtëm.

Znj. Hoxha është njohëse e Gjuhës Angleze dhe Gjuhës Italiane.



## Kontakt

 [ermirahoxha@klsh.org.al](mailto:ermirahoxha@klsh.org.al)

 Rruga “Abdi Toptani”, Tiranë,  
Shqipëri

 [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al)